

BRIKENA SMAJLI

NJË VËSHTRIM I POEZISË SË M. CAMAJT NËPËRMJET T. S. ELIOT-IT

Konceptin e kuptimit historik¹ të shtjelluar nga Elioti në *Tradita dhe talenti individual* mbi rolin e traditës dhe kultivimin e talentit individual në letërsi² nuk mund të mos e kemi parasysh edhe në lexim-vlerësimin e autorit të letërsisë shqipe, Martin Camajn. Vepra e tij, poetike i përgjigjet kësaj mendësie mbi shkrimin, qoftë në drejtim të qasjes ndaj traditës (kuptimi historik) dhe bashkëkohësisë, qoftë edhe ndaj asaj që Elioti në esenë tjetër të mirënjohur të tij *Uliksi, rendi dhe miti* e quan *metodë mitike*.³ (etnologjisë dhe mitit). Pyetjes sonë se si mund të gjallojë dhe përsoset një letërsi dhe poezi, larg lexuesit të vet natyral dhe në marrëdhënie me kulturat e tjera poetike, shumë më në zë dhe më të sistemuara në lidhje me ligjërimin poetik, autorin

¹ ELIOT, T. S. Tradition and the Individual Talent, *Selected Essays*, Faber and Faber, London, 1934, f. 14. ...kuptimi historik e detyron një njeri të shkruajë jo thjesht me brezin e tij në shpirt, por me një ndjenjë që tërësia e letërsisë europiane nga Homeri dhe bashkë me të, tërësia e letërsisë së vendit të tij, ka një qenësi të menjëhershme dhe i përbën një rregull i njëhershëm. Ky kuptim historik, i cili është një kuptim i pakohësisë, po aq sa i përkohësisë dhe i pakohësisë e përkohësisë njëkohësisht, është ai që e bën një shkrimtar tradicional. Ky është në të njëjtën kohë, ai që e bën një shkrimtar në mënyrë më domosdoshmërisht të vetëdijshëm për vendin e tij në kohë, për bashkëkohësinë e tij.

² Eseja u botua së pari më 1919 në revistën "The Egoist" dhe pati një ndikim jo vetëm në vështrim-leximin e poezisë së Eliotit, por edhe në vështrimin e kritikës letrare ndaj veprave poetike të modernizmit anglez dhe më gjerë.

³ ELIOT, T. S. " 'Ulysses,' Order, and Myth," *Selected Prose of T. S. Eliot: The Centenary Edition 1888-1988*, ed. Frank Kermode, New York, Harcourt Brace Jovanovich and Farrar, 1988, f. 177-178. Duke përdorur mitin, duke përpunuar një paralele të vazhdueshme midis bashkëkohësisë dhe lashtësisë, z. Joyce po ndjek një metodë të cilën të tjerë do ta ndjekin pas tijl...[Kjo është veç një mënyrë të kontrolluari, të rendituri, të formësuarit e një panorame të paanë kotësie dhe anarkie, siç është historia bashkëkohore. Kjo është një metodë e përvijuar tashmë nga z. Yeats, për nevojën e së cilës, unë besoj se z. Yeats ka qenë i pari bashkëkohës i vetëdijshëm. Kjo është një metodë për të cilën horoskopi është i mbarë. Psikologjia (e tillë siç është edhe nëse kundërveprimi ynë ndaj saj është komik apo serioz), etnologjia dhe Dega e artë kanë pajtuar për të bërë të mundur atë që vetëm pak vite më parë ishte e pamundur. Në vend të metodës narrative, ne tani përdorim **metodën mitike**.

dhe traditën,⁴ Camaj i është përgjigjur fare mirë me një marrëdhënie me kulturën e kulturat, që drejtpeshohet jo kundrejt lexuesit të tij të një kohe, por të ngjashmëve të tij të gjithkohshëm. Nga ky pikëvështrim eliotian ai ka krijuar marrëdhënie të drejta me traditën poetike së cilës i përket, në traditë dhe vazhdimësi; traditat poetike europiane a më gjerë dhe bashkëkohësinë. Për këtë autori Camaj është edhe i vetëmjaftueshëm brenda gjuhës a kulturës poetike, si edhe, shfaqet po aq i mirëdrejtuar në poezinë bashkëkohore të gjysmës së dytë të shek. 20-të, duke ruajtur e kultivuar në këtë qasje edhe zërin e tij poetik. Prandaj, krahasimi i poezisë së tij në drejtim të ndikimeve, me qëllim përkufizimin saj është, sigurisht, i pa suksesshëm. Ndikimet, përkimet, qasjet janë kalimtare dhe ndërtekstualiteti është sugjerues, gjithmonë në drejtim të përrimit të një poezie autoriale. Përmes këtij punimi të shkurtër ne hedhim një vështrim tekstual ndaj poezisë së Martin Camajt, duke ndjekur një nga “çelësat” poetik, që Camaj vetë na sugjeron, Eliotin.

Duke iu referuar jetës dhe shkollimit, Camajn e kanë krahasuar me Giuseppe Ungaretti-n, meqë autori shqiptar ka ndjekur për disa kohë leksionet e tij, qasje kjo, që, siç thamë më lart, duhet marrë jo pa mëdyshje.⁵ Një lexim në vijimësi i veprës poetike të Camajt, që nga *Nji fyell ndër male* - Prishtinë 1953 dhe *Kanga e vërrinit* - Prishtinë 1954, deri tek veprat e fundit poetike *Palimpsest* si edhe e traditës prej së cilës kjo poezi vjen e formohet, na plotëson më së miri ecurinë e zhvillimin e saj. M. Camaj, si i lindur në Temal të Dukagjinit, është mburrur me natyrën e vështrimit të botës atje si edhe me të folmen, jo pak idiomatike të krahinës; ritmikën e të menduarit dhe të shprehurit, në dukje naive dhe primitive, fillimore, prej të cilës ndërtimi "hermetik" i vargut, strukturat shumështrësore të mendimit, vijnë natyrshëm.⁶

⁴ MARASHI, Ardian. *Letërsia e sotme: kërkime dhe dilemma*, Në kërkim të një horizonti të ri kulturor (Përmbledhje studimesh), Shtëpia Botuese “55”, Tiranë, 2006, f. 12. *Në rrafshin e zhvillimeve letrare botërore, letërsia shqipe përbën një rast jo të zakonshëm, të ngjashëm ndoshta vetëm me letërsinë izraelite. Pavarësisht nga vendi që zënen njëra dhe tjetra në klasifikimin global, si njëra ashtu edhe tjetra shëmbëlajnë me një mozaik të krisur.*

⁵ *Nga interpretët sipërfaqësorë të veprës së Camajt procedimi në fjalë u quejt “ndikimi i poetit Ungaretti”. Kemi me ba një sillogjizëm klasik: në universitetin e Romës Martini kishte ndjekë ligjëratat e Ungaretti-t (por edhe të shumë profesorëve të tjerë), Ungaretti ishte poet i “hermetizmit” italian, poezia e Camajt është hermetike, prandaj: poezia e Camajt është e ndikueme nga ajo e Ungaretti-t. Shih: LANKSCH, Hans-Joachim “Martin Camaj, një djalë bariu bahet poet i rangut botnor”, në “Haemus” 2-3/1999, București, f. 27.*

⁶ SINANI, Shaban. “Camaj i paskajuar”, studim monografik për krijimtarinë e Martin Camajt, Sh.B. “Naimi”, Tiranë, 2011, f. 44. “Errësia” e leximit të saj lidhet jo me

Ruajtja e kësaj marrëdhënieje përkatësie dhe kultivimi i saj, në drejtim, të shprehjes poetike përbën risinë e qëndrueshme tek poezia e M. Camajt dhe e lidh këtë të fundit me zhvillimet poetike të përruar nga Elioti, atë të *Metodës mitike*.⁷

Ndërsa vazhdon dhe përtërin një traditë të historishkrimit shqiptar që nga fillimet (Buzuku, Budi, Bogdani) Camaj në poezinë e tij kultivon vëmendjen sistemore për t'i dhënë traditës shqiptare dhe vetëdijes ndaj saj në poezinë e tij, qëndrueshmëri. Ndërsa kjo e pasuron me forma e shprehje dhe e vetëdijëson në risitë shkrimore të poetikës shqipe, nuk e kthen autorin në izolimin lokal, krahinor. Përkundrazi, marrëdhënia tjetër e qëndrueshme me kulturën poetike europiane a të ngjashmit e tij gjithkohorë i jep ndërtekstualitetit të poezisë së tij strukturën shumështrësore të mendimit, prej nga kumti poetik është i gjithkohshëm.

Duke analizuar poezinë e mëposhtme vërejmë jo thjesht sugjerimin e autorit për një lexim eliotian, por edhe mendësinë e përruar nga Elioti si kuptim historik mbi tekstin dhe marrëdhënien e shënuar me poetikën mitike.

T. S. Eliot

Martin Camaj

Rose of Memory

T.S. Eliot

1. Kur e varën në litár
2. Záni i tinglloi kumbonë.

3. Dielli i mbèt i ngrimë
4. Në sý.

5. Gojë-gojë iu derdhën
6. Vija vija ngjyra ylberi në parzëm.

7. Në çdo dhamb
8. I varej minuti i vet
9. Një pë i hollë

10. e n'andërr e shohim

fshehjen qëllimore të kuptimit, por me lakonizmin tipik të ligjërimeve më konservative të shqipes, me të cilat poeti ishte rritur.

11. kapë për gishta tonë
12. e zgjatet e zgjatet
13. mbas nesh kudò që vemë
14. e nuk harrojmë.⁸

Në këtë poezi të Camajt marrëdhëniet sugjeruese janë të dallueshme. Poezia edhe pse nuk i kushtohet Eliotit, kërkon të lexohet nëpërmjet njohjes së poezisë së këtij të fundit. Këtu vihet në dukje pëlqimi i tij ndaj poetit anglo-amerikan; pohim, të cilin e thekson edhe Hans Joachim Lanksch në një intervistë të datës 14 qershor 2005: "*Camaj ishte lexues jo vetëm i Ungarettit, por i shumë autorëve të tjerë, ku autorë të preferuem i kishte Juan Jiménez dhe T. S. Eliot.*"⁹ Por edhe këtu qasja tekstore ndaj poezisë së Eliotit, edhe pse e shpallur dhe me qëllimësi, duhet parë si, shtysë, kumtim, jo si ndikim. Qasje të tilla ndërtekstuale, shtysa siç mund të ketë ndodhë, pa dyshim, ajo ndaj *Komedisë hyjnore* të Dantes dhe *Tokës së Shkretë* të Eliotit, nënvizon H. J. Lanksch,¹⁰ janë rrjedhojë e kësaj domosdoje kumtimi mes poetit dhe poezisë si edhe të ngashmëve të tij. Leximi i kësaj poezie nën dritën e leximit poetik të Eliotit, për çudi, ndërton marrëdhënie ndërtekstorësie me poemën e Eliotit *E mërkura e përhime: Rose of memory*¹¹ nuk përmendet fare në *Tokë e shkretë*.

⁸ CAMAJ, Martin. *Lirika*, "Dukagjini", Pejë, 2000, f. 583.

⁹ LANKSCH, H. J. "Ç'nuk ishte Martin Camaj : me rastin e 80 vjetorit të lindjes së shkrimtarit Martin Camaj (25 qershor 1925 - 2005) Gazeta shqiptare ("Milosao", suplement). - f. 70, 26 qershor, 2005, f. 4 - 5

¹⁰ Po aty, f. 5. *Vetë Camaj thoshte – më tepër më ka bërë përshtypje Quasimodo dhe, deri diku, Montale. Njihërë ia tregova Martin Camajt poezinë e Giovanni Pascoli "Il gufo", atmosfera dhe imazheria e së cilës ngjason me "Qokthin" e Camaj sikurse të ishte simotra e atij të fundit. Camajt nuk iu kujtue se e paskej lexue poezinë e Pascoli, mirëpo tha, jo pa çudi, se duhej me kenë fjala për një reminishencë nga lektura e tij. Me sa bërë fjala për "ndikime", ndoshta kishte me kenë më tepër e udhës me folë për shtysa. Pa dyshim Martin Camaj merrte shtysa nga leximi i tij i gjanë i letërsisë prej [i]"La divina commedia" [i]deri te "The Waste Land". Me siguri njohja me procedeu poetik eliptik të hermetizmit italian e shtyste Camajn me përkrye udhën poetike që e kishte marrë qysh përpara, udhën e reduktimit të tekstit poetik në një minimum fjalëpak, pa stolisje të panevojshme, mbi fundamentin e vargut popullor shqiptar tue i derdhë imazhet, ndjesitë dhe mendimet në formula poetike të cilat, përndryshe, janë edhe komponente themeltare të poezisë popullore.*

¹¹ Shih. ELIOT, T. S. *Collected poems 1909-1962*, Faber&Faber, London, 1963, (Ash Wednesday, II) f. 97-98. *Lady of silences/Calm and distressed/Torn and most whole/Rose of memory Rose of forgetfulness/ Exhausted and life-giving/Worried reposeful/ The single Rose/ Is now the Garden/ Where all loves end / Terminate torment/ Of love unsatisfied/ The greater torment/ Of love satisfied/ End of the endless/*

Për leximin eliotian, simbolika e trëndafilin – duhet të ishte ajo e plotësisë, arritjes përmblylëse, përkryerjes,¹² ashtu siç e ndeshim edhe tek Dantja në Parajsë,¹³ (reminishencë e së cilës edhe pjesa nga poema e Eliotit është) dhe, sigurisht nuk i përgjigjet natyrës së shkrimit të *Tokës së shkretë*. Për Eliotin, kujtesa ka të bëjë me *Zonjën e qetësisë... të mekur dhe jetëdhënëse, Trëndafilin e vetëm në Kopësht...*¹⁴ Zhvendosja e përfytyrimit nga Parajsa tek Purgatori është e qartë. Në poezinë e M. Camajt lidhjen mes dy autorëve e bën *Trëndafilin*, më saktë titulli i poezisë, *Trëndafil i kujtesës* (Rose of Memory) si tek Dantja dhe Elioti, por tek poezia e Camajt ai nuk përfaqëson Shën Mërinë, por Krishtin, si *Trëndafilin mistik*. Kumbimi i Camajt për Eliotin, ka të bëjë me Krishtin edhe ngaqë edhe vetë *E mërkura e përhimë* është shkruar me këtë frymë kristiane.¹⁵

Sugjerimi simbolik Trëndafilin/ Krisht tek Camaj kundrejt Trëndafilin/Shën Mëri tek Dante dhe Elioti, ka të bëjë edhe me përveçimin autorial, të nxitur edhe nga përkatësia sistemore-kulturore, për të ndërtuar nëpërmjet ndërtektorësisë një kumbim gjithkohor, parallel dhe i mirëvendosur kundrejt autorëve, si një lexim dhe rilexim i tyre, në kontekstualizimin shqiptar. Përkatësia shqiptare, si trashëgimi gjuhësore, kulturore dhe psikologjike për një poet, që mirëfilli krijimtarinë e tij, e ndërton hap pas hapi dhe shtresë pas shtrese nëpërmjet sendërtimit të gjuhës prej nga vjen, përkatësisë kombëtare a krahinore, në gjuhë dhe psikologji, struktura mendimi a më gjerë, vjen e bëhet më e qëndrueshme, sa më tepër autori i tyre i afrohet synimit më të lartë poetik të vet. Autori, Camaj, ndërsa ruan marrëdhënie tekstore me bashkëkohësit a të ngjashmit poetikë, Eliotin dhe traditën poetike, Danten i kthehet botvështrimit shqiptar në gjuhë dhe përfytyrim.

Poezia e Camajt, ndërsa ndërlihdh, në pak rreshta, dy emra të rëndësishëm poetikë të kulturës njerëzore: Danten (Pararendësin e Rilindjes europiane, Italian) dhe Eliotin (Modernist, Anglez), e zhvendos vëmendjen në Shqipëri. Titulli *Rose of memory*, ndërsa sjell në kujtesë trëndafilin e Dantes në

Journey to no end/Conclusion of all that/ Is inconclusible/Speech without word/and Word of no speech / Grace to the Mother/ For the Garden/Where all love ends.

¹² CIRLOT, J. E. *A Dictionary of Symbols*, Second Edition, Routledge, London, 2001. (nëntitulli: Rose, f. 275.)

¹³ ALIGHIERI, Dante, *Paradiso*, Edizione di riferimento: I Meridiani, I edizione, Mondadori, Milano 1991, (Introduzione, cronologia, bibliografia, commento a cura di Anna Maria Chiavacci Leonardi), vv 23.73--74.

¹⁴ ELIOT, T. S. *Collected poems 1909-1962*, Faber&Faber, London, 1963, (Ash Wednesday, II) f. 97-98.

¹⁵ Poema "Ash Wednesday" është botuar më 1930, pas konvertimit të Eliotit në katolik, më 1927.

Parajsë dhe atë purgatorial të Eliotit, duke e zhvendosur vëmendjen nga Shën Mëria, tek Krishti, sjell ferrin tokësor në përfytyrimin poetik të lexuesit.

Parajsa – Dante → Purgatori, Eliot → Ferri, Camaj.

Vëmendja që autori do të na sugjerojë ka të bëjë sjelljen në kujtesë të kësaj përvoje të fundit, nëpërmjet gjuhës sugjeruese të kujtesave të tjera, për të dalluar edhe shmangien autoriale. Si koncept, nëse *Trëndafili i kujtesës* është Krishti, ai nuk është marrë në simbolikën përkatëse, as të sugjeruar nga Dante tek Parajsa¹⁶ dhe as nga Elioti, si një gjendje purgatoriale, ku vihet re figura e *Zonjës së qetësisë*, si Trëndafil i kujtesës; tek M. Camaj Krishti-Rose of memory është tokësor, në çastin sublim të kryqëzimit/(varjes)...

Shmangiet tekstuale poetike nga Ngjarja (kryqëzimi i Krishtit), theksojnë edhe më përveçimin autorial, duke shënuar jo Krishtin e kryqëzuar në Golgota, por atë gjithkohorin të kryqëzuar edhe në Shqipëri (khs, *e varën në litër* (v. 1)/ *kryqëzuan*). Më tej ende leximi i poezisë në këndvështrimin e Ngjarjes, nën dritën e përkryerjes së Dantes (Parajsës) dhe pastrimit të Purgatorit të *E mërkura e përhimë* është leximi i Ndodhisë shkak, jo pasojë. Krishti është marrë këtu në arketipin fillimor; është fara që do të çelë një trëndafil...prej këndeje *Rose of memory* është kjo Ngjarje, që ripërtërihet në kujtesë, *kapë për gishta tonë e zgjatet e zgjatet mbas nesh, kudo që vemë*¹⁷ duke sjellë prej ferrit tokësor të saj, shëlbim/shpëtim. Kujtesa është *zâ* i jehuar atë çast. Në poezi nuk ka asnjë shenj gjaku, veç ky *tingull/ zâ*, që *derdhet/jehon*, e mblidhet në *kumbonën/kupën* e Grailit... Jeta tokësore e Krishtit na sugjerohet vetëm tek vargjet:

7. *Në çdo dhamb*

8. *I varej minuti i vet*

9. *Një pë i hollë*¹⁸

Ku aludohet për moshën e Krishtit, nëpërmjet dhëmbëve (32) për çdo të tillë, një agoni vdekjeje e lidhur për minutë/orë.

Camaj, - *shprehet studiuesi Sh. Sinani,- nuk ndihej mirë brenda një shkolle, brenda një tradite, brenda një letërsie. Për të krijuar një poezi origjinale ai para së gjithash shtegtoi brenda vetes.*¹⁹

¹⁶ALIGHIERI, Dante, *Paradiso*, 23. 70-75. *Perché la faccia mia sì t'innamora,/che tu non ti rivolgi al bel giardino/che sotto i raggi di Cristo s'infiora? /Quivi è la rosa in che 'l verbo divin/carne si fece; quivi son li rigli.*

Përkthimi shqip : *Pse veç fytyrën time dashuron?/ dy sytë e tu kah kopshti i bukur silli, që nën rrezet e Krishtit lulëzon!/ Atje asht trëndafili, tek i cilli/ trup verbi i Hyut u ba, atje-zambakët,/ që me aromë rrugën treguen mirëfilli.* Shih. ALIGHIERI, Dante. *Komedia Hyjnore*, përktheu: Pashko Gjeçi, Argeta-LMG, Tiranë, 2006. f. 502.

¹⁷ CAMAJ, Martin. *Lirika*, "Dukagjini", Pejë, 2000, f. 583. Vv. 10-13.

¹⁸ Po aty, vv: 7-9.

Teksti, prozodia e poezisë së Camajt është tepër larg, formës dhe shprehjes eliotiane. Poezia e Eliotit shquhet, ndër të tjera, për sjelljen e ritmikës së ligjërimin bisedor në poezi, si edhe organizimin me një bazë të caktuar muzikore. *E mërkura e përhime* (*Ash Wednesday*) është ndërtuar mbi muzikën e Bethovenit, kuarteti A minor, opus 132.²⁰ Për këtë rol të rëndësishëm në ritmikën e poemës luajnë përsëritjet, organizimet tingullore, rimat e brendshme dhe të jashtme. Organizimi i poezisë së Camajt, përkundrazi, as që i përgjigjet një poetike të tillë. Duke ruajtur marrëdhënie sugjeruese me tekstet e Dantes dhe të Eliotit, ai rreket të ndërtojë një Ngjarje, e cila poetizohet nëpërmjet intensitetit dhe imazhit, por jo muzikalitetit tipik të poezisë. Poezia vepron si një unitet sintaksor e tekstor dhe, lexohet pikërisht për këtë, si Ngjarje, në stilin biblik të parabolave. Formalisht teksti është poezi, por qëndron shumë mirë edhe në formë proze.

Rose of Memory

T. S. Eliot

1. *Kur e varën në litár, zâni i tinglloi kumbonë. Dielli i mbèt i ngrimë në sý. Gojë-gojë iu derdhën vija vija ngjyra ylberi në parzëm. Në çdo dhamb i varej minuti i vet - një pë i hollë e n'andërr e shohim kapë për gishta tonë e zgjatet e zgjatet mbas nesh, kudò, që vemë e nuk harrojmë.*²¹

Ndërsa leximi në formë poezie, sugjeron pikërisht të folurin idiomatik dhe mjeshtërinë e të folurit ngadalë të malësive, prej fjalëve të shkëputura të të cilëve, ligjërimin kësisoj, fitohet një vëmendje më e madhe mbi fjalën dhe vlerën kuptimore e sugjeruese të saj, kundrejt fjalisë. Dy veprat poetike të autorëve Dante dhe Eliot, përkundrazi kanë një frazë poetike të shtrirë, të organizuar në strofa (tercina) dhe ritëm rrëfimi alegorik, Dante dhe *lëvizje muzikore* tek Elioti.

Kjo vjen edhe prej një fakti të thjeshtë se qasja qoftë edhe imituese e një poeti shqiptar (me kult gjuhën) ndaj një poeti anglosakson është ku e ku e pamundur për shkak të natyrave krejt të ndryshme morfostrukturore dhe psikologjike, të gjuhës dhe të sistemeve kulturore, që vihen përballë: anglishtes dhe shqipes-gege.

Pikërisht për këtë qasja tekstuale Eliot-Camaj në poezi, ndërsa gjen të përbashkëta tematike e sugjerime edhe ndërtekstualizim, qasje ndaj mitit dhe simbolikës; është sendërtim rranjesh të ndryshme. Tek Elioti, peshojnë jo pak

¹⁹ SINANI, Shaban. "*Camaj i paskajuar*", studim monografik për krijimtarinë e Martin Camajt, Sh. B. "Naimi", Tiranë, 2011, f.45.

²⁰ SPENDER, Stephen. *Eliot*, ed. Frank Klermode, Fontana Modern Masters, FP, Glasgow, 1986, f. 128.

²¹ CAMAJ, Martin. *Lirika*, "Dukagjini", Pejë, 2000, f. 583.

kultura poetike anglo-saksone, formimi poetik-prozodik francez dhe gjerman, si edhe psikologjia (disi e mohuar) amerikane, përfshi këtu edhe gjithë trashëgiminë kulturore të njerëzimit. Camaj është shqiptar i veriut dhe ...për më tepër, ka patur mençurinë e ngasjen, që gjuhën prej nga vjen edhe është, ta studiojë në thellësi, si prozodi dhe trashëgimi popullore, si edhe njohje sistimore, prej së cilës e ka lehtësisht të mundur t'i mbijetojë peshës sistimore të kulturave të mëdha poetike, qoftë kjo edhe kultura kozmopolite anglosaksone, në bashkëkohësi edhe në traditë.²² Tek poeti shqiptar, M. Camaj, peshon jo pak sistemi poetik shqiptar (përveçimi geg) me figura të tilla të traditës së shkrimit që nga Buzuku, Budi, Bogdani, Matrënga dhe deri tek Fishta dhe Mjeda. Jo më pak e rëndësishme paraqitet tradita poetike e zhvilluar tek arbëreshët, mbledhës, studiues i të cilës është edhe vetë autori. Po kështu njohja e poezisë lindore (poezia baltike), ajo italiane, franceze, gjermane, angleze.

Prandaj themi se këtu sigurisht kemi të bëjmë me elita kulturore, marrëdhëniet e të cilëve, mes tyre, janë marrëdhënie të ngjashmish. Në këtë qasje të ngjashmish, asaj të Camajt ndaj poezisë së Eliotit, në drejtim të teknikës së strukturimit të vargut, afrisë ndaj mitit, ritualit, duhet të kemi parasysh edhe zhvendosjen në kohë të poetëve, prej së cilës asnjë ndikim, sado besnik, nuk mund të jetë formësues plotësisht i një autori tjetër edhe sikur ky t'i përkasë të njëjtit sistem kulturor (anglez) apo të jetë i dhënë pas poezisë së tij si Camaj. Vështrimet në planet të reja kohore të poetikave, kthimet e rishikimet teknike e prozodike, qasjet ideore a figurative janë, sidoqoftë, rilexime, të cilat, duke humbur bashkëkohësinë apo “modën poetike”, në realizimet edhe më besnike (përjashtojmë imitimin e vjedhjen) kanë vulën e rishkrimit personal si edhe një marrëdhënie më të re ndaj gjuhës, në radhë të parë. Për këtë arsye, ndërsa Camaj vetë na sugjeron Eliotin si një nga çelësat e tij poetik të poezisë, ne do ta krahasojmë leximin eliotian të Camajt të ngjashëm me atë të Heaney-t.

Literatura

ALIGIERI, Dante. *Komedia Hyjnore*, përktheu: Pashko Gjeçi, Argeta-LMG, Tiranë, 2006, f. 502.

ALIGIERI, Dante. *Paradiso*, Edizione di riferimento: I Meridiani, I edizione, Mondadori, Milano 1991, (Introduzione, cronologia, bibliografia, commento a cura di Anna Maria Chiavacci Leonardi), vv 23.73-74.

²² Duke qenë poet në pasion, M. Camaj është edhe pedagog dhe studiues i gjuhës shipe. Krahas 150 artikujve shkencorë, kemi edhe këto botime, me rëndësi, të tij, në fushë të shqipes si gjuhë dhe kulturës së saj. Shih CAMAJ, Martin. *Lirika*, “Dukagjini”, Pejë, 2000, f. 720.

- CAMAJ, Martin. *Lirika*, "Dukagjini", Pejë, 2000, f. 583.
- CIRLOT, J. E. *A Dictionary of Symbols*, Second Edition, Routledge, London, 2001. (nëntitulli: Rose, f. 275.)
- LANKSCH, Hans-Joachim. *Ç'nuk ishte Martin Camaj : me rastin e 80 vjetorit të lindjes së shkrimtarit Martin Camaj (25 qershor 1925 - 2005)* Gazeta shqiptare ("Milosao", suplement). - p. 70, 26 qershor, 2005, f. 4 - 5
- LANKSCH, Hans-Joachim. "*Martin Camaj, një djalë bariu bahet poet i rangut botnor*", në "*Haemus*" 2-3/1999, București, f. 27.
- ELIOT, T.S. *Collected poems 1909-1962*, Faber&Faber, London, 1963, (Ash Wednesday, II) f. 97-98.
- ELIOT, T. S. *Tradition and the Individual Talent*, *Selected Essays*, Faber and Faber, London, 1934, f. 14.
- ELIOT, T.S. " *'Ulysses,' Order, and Myth.*" *Selected Prose of T. S. Eliot: The Centenary Edition 1888-1988*, ed. Frank Kermode, New York, Harcourt Brace Jovanovich and Farrar, 1988, f. 177-178.
- MARASHI, Ardian. *Letërsia e sotme: kërkime dhe dilemma*, Në kërkim të një horizonti të ri kulturor (Përmbledhje studimesh), Shtëpia Botuese "55", Tiranë, 2006, f. 9-45.
- O'DONOGHUE, Bernard. *The Cambridge Companion to Seamus Heaney* / edited by Bernard O'Donoghue, Cambridge UP, 2009, p. 225. *Andrew Murphy, Heaney and the Irish Poetic Tradition*, f. xvii. f. 136-143
- SINANI, Shaban. *Camaj i paskajuar*, studim monografik për krijimtarinë e Martin Camajt, Sh. B. "Naimi", Tiranë, 2011, f. 44
- SPENDER, Stephen. *Eliot*, ed. Frank Kermode, Fontana Modern Masters, FP, Glasgow, 1986. f. 128.
- WILSON, Edmund. *Axel's Castle; A study in the Imaginative Literature of 1870-1930*; New York 1931, f. 26-27.

SUMMARY

This study used to construct the idea of the role of tradition as national cultural system (ethnology and myth and poetical writing history) toward the other cultural systems as such in the construction of a poetical personality. Keeping in mind two important essays of T. S. Eliot, Tradition and Individual Talent and Ulysses, Order and Myth, we saw the poetry of M. Camaj in comparison with Eliot's poetry, through intertextuality and suggestion. Analysing a poem, Rose of memory, as it is the only one who call in mind Eliot's poem textually, Ash Wednesday we saw the intertextuality of Eliot and Dante to Camaj as suggestive communication and the poetry as an example of poetical authority.

